

VENDIM
Nr. 283, datë 13.4.2016

PËR SHPALLJEN E LIQENIT TË OHRIT SI ZONË BASHKËMENAXHUESE
PESHKIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e liqenit të Ohrit si zonë bashkë-menaxhuese peshkimi, për të ushtruar aktivitetin e peshkimit tradicional.
 2. Plan i bashkëmenaxhimit për liqenin e Ohrit miratohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, brenda 12 muajve nga data e miratimit të kësaj zone.
 3. Plan i bashkëmenaxhimit, sipas pikës 2, të jetë në përputhje me planin e menaxhimit të basenit Drin-Buna.
 4. Veprimtaritë dhe investimet që do të kryhen në liqenin e Ohrit të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura dhe me objektivat e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur të liqenit të Ohrit.
 5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi